

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN

PËR
NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10316, DATË 16.9.2010 “PËR
DISA SHITESA NË LIGJIN NR.7764, DATË 02.11.1993 “PËR INVESTIMET E
HUAJA””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Ky projekt ka si qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me investimet e huaja dhe garantimin e tyre në një nivel më të lartë.

Kjo nismë synon t'i ofrojë me tepër garanci dhe siguri juridike investitorëve të huaj, të cilët investojnë në Shqipërisë, veçanërisht për sa i përket ofrimit të garancive për çështjet e pronësisë dhe garantimit të titujve të pronësisë përballë palëve të treta. Kjo pasi çështjet e pronësisë apo pasiguria juridike, ndikojnë negativisht në investimet aktuale apo në investimet e pritshme.

Investitorët vuajnë pasojat e kësaj shtate për shkak të pasigurive juridike që paraqesin titujt e pronësisë dhe nevojës për garanci shtesë, ndërsa nga ana tjetër kjo shtate rendon mbi ekonominë vendase.

Rrjedhimisht kjo nismë synon t'i mundësojë investitorëve strategjike dhënien e garancive shtese nga shteti, nëpërmjet mbrojtjes së posaçme shtetërorë për ato situata që shfaqin pasiguri juridikë për këta investitorë.

Në këtë mënyrë është e mundur të shtohet niveli i besueshmërisë si dhe konsolidohet klima e biznesit në vend, çka mund të përkthehet me një shtim te investimeve ne nivel afat shkurtër.

Për sa me sipër është hartuar ky projektligj

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin analitik të MZHETTS për vitin 2017.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Një pjesë e investimeve të huaja të parashikuara për t'u realizuar në vendin, disa herë janë shtyrë në kohë apo në raste të tjera nuk janë realizuar për shkak se ato janë përballur me një shtatë pasigurie juridike, e cila ka efekte negative si për shtetin dhe investitorët. Kjo shtate vërehet shpesh ne lidhje me çështjet e pronësisë dhe pasigurinë qe sjellin për investimet paqartësitë e titujve te pronësisë.

Pasiguria juridike e titujve te pronësisë është shtuar edhe me shume nisor edhe nga gjendja e sistemit gjyqësor shqiptar.

Për t'ju përgjigjur kësaj problematike Kuvendi i Shqipërisë ne vitin 2010 miratoi disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.7764, date 02.11.1993, me qellim dhënien e një mbrojtjeje te posaçme për investitorët e huaj. Konkretisht përfshirja e mekanizmit te mbrojtjes se posaçme shtetërore ne vitin 2010 synonte mbrojtjen e investimeve te huaja ne rastet kur, për shkak te konflikteve gjyqësore me pale te treta private pengohet realizimi i investimit. Kjo mbrojtje parashikonte zëvendësimin me te drejta te plota te investitorët e huaj nga ana e shtetit shqiptar ne një konflikt me pale te treta. Sidoqoftë një nga kufizimet e këtij ligji është se kjo mbrojtje e posaçme shtetërore ishte e kufizuar ne kohe deri me date 31.12.2014.

Për këtë qellim, veçanërisht për garantimin e titujve te pronësisë mbi te cilat këto investitorë kane kryer investime është e nevojshme ofrimi i garancive dhe mbrojtjeve te përshtatshme, me anën e mbrojtjes se posaçme shtetërore.

Për sa me sipër është hartuar ky projektligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është hartuar ne mbështetje te nenit 81, pika 1 dhe 100 te Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk ka

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i ndarë në 2 nene.

Në nenin 1 ne piken e parë është parashikuar zgjatja e afatit te mbrojtjes se posaçme deri me datë "31 Dhjetor 2018".

Ne piken e dyte është parashikuar shtimi i një paragrafi me kete përmbajtje:

"Mbrojtje të posaçme shtetërore sipas parashikimeve të neneve 8/b, pikave 1, 2 dhe 4; 8/d dhe 8/dh të këtij ligji, përfitojnë automatikisht, pa patur nevojën e ndjekjes se procedurës së parashikuar në nenet 8/c dhe 8/ç, dhe investitorët/investimet strategjike, procedurë e asistuar/e veçantë që kanë marrë këtë status në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen te gjitha institucionet.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me shpenzime shtesë financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI

MILVA EKONOMI